Kuzhina Qendrore

Ndërmarrje publike lokale | Rr. Egnati p.n. - 10 000 Prishtinë | www.kuzhina.net | kuzhinaqendrore@gmail.com

Prishtinë më 07.04.2022

Në bazë të LIGJI NR. 03/L-087 PËR NDËRMARRJET PUBLIKE, Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve bënë këtë:

FTESË

Të merrni pjesë në mbledhjen e 6/22 të Bordit të Drejtorëve të NPL "Kuzhina Qendrore" sh. a.

Data e takimit: 27 Prill 2022
Ora: 17:30
Vendi: Salla e takimeve – Objekti i Kuzhinës, rr. Egnatia, Lagja Ulpianë

Propozim rendi i ditës

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes se 5/22 të Bordit të Drejtorëve
2. Miratimi i Raportit tre mujore të punës
3. Miratimi i Propozim Rregullores për Përgjegjësin Disiplinore dhe Materiale ;
4. Të ndryshme

Me respekt:
Qendrim Vitija
Kryesues i Bordit të Drejtorëve

Kuzhina Qendrore

Ndërmarrje publike lokale | Rr. Egnatia p.n. 10 000 Prishtinë | www.kuzhina.net| kuzhinaqendrore@gmail.com

Prishtinë, 27.04.2022

Bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Statutin e NPL Kuzhina Qendrore sh.a. Bordi i Drejtorëve nxjerr këtë:

Konstatim

Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale Kuzhina Qendrore sh.a., në mbledhjen nr. 06/22 të mbajtur më 27 Prill 2022, ka miratuar:

Raportin e punës për periudhën 1 Janar – 31 Mars 2022.

Rregullorja hynë në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve.

z. Qendrim Vitija,

Kryesues i Bordit

Ndërmarrje publike lokale | Rr. Egnatia . - 10 000 Prishtinë | www.kuzhina.net| | kuzhinaqendrore@gmail.com

RAPORT I PUNËS

(1 Janar – 31 Mars 2022)

Prishtinë, Prill 2022

Përmbajtja

Lista e shkurtesave 3
Përmbledhje ekzekutive 4
Për ndërmarrjen 6
Vizioni i Kompanisë 6
Misioni i Kompanisë 6
Qëllimet 6
Objektivat e ndërmarrjes 7
Korniza Ligjore 7
Bordi i drejtorëve 8
Zyra e Kryeshefit 9
Memorandume bashkëpunimi dhe marrëveshje për shërbime 9
Takime pune 9
Informimi dhe avokimi 11
Zyra e Prokurimit 12
Tab. 1. Aktivitetet e Zyrës së Prokurimit 12
Departamenti i Administratës 12
Departamenti i Prodhimit 14
Tab. 2 Përgatitja e shujtave Janar – Mars 2022 14
Departamenti i Financave 15
Tab. 3 Shpenzimet për paga dhe kompensime të tjera 15
Tab. 4 Pagesa për anëtarët Bordit të Drejtorëve dhe Komisionin Komunal të Aksionarëve 16
Tab. 5 Shpenzimet për mbushje telefonike dhe Shpenzimet e mbledhjeve. 16
Tab. 6 Shpenzimet e reprezentacionit 16
Obligimet Tatimore 17
Tab. 7 Llogaritja e tatimit në fitim 17
Tab. 8 Pagesa e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) 17
Tab. 9 Ndëshkimet në vonesa 17
Shpenzimet e tjera 17
Tab. 10 Mallra dhe shërbime 18
Ngritja e kapaciteteve të ndërmarrjes 18
Anex 1 Lista e Institucioneve parashkollore 18

Lista e shkurtesave

NPL – Ndërmarrje publike lokale

KQ- Kuzhina Qendrore

KK – Kuvendi Komunal

KP- Komuna e Prishtinës

KA – Komisioni i Aksionarëve

KB - Kryesuesi i Bordit

DB – Drejtorët e Bordit

KAB – Komisioni i Auditimit të Brendshëm

KE – Kryeshefi Ekzekutiv

QKMF - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

IP - Institucionet Parashkollore.

Përmbledhje ekzekutive

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, neni 31 paragrafi 31.1, brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin dhe dorëzojnë në Bordin e Drejtorëve një raport për tremujorin e sapo përfunduar.

Sipas Ligjit Raporti tremujore, duhet të përmbaj një pasqyrë të strukturës organizative të NP, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e konsiderueshme që janë bërë gjatë tremujorit përkatës; një shqyrtim të përformancës afariste dhe financiare gjatë tremujorit përkatës; një përmbledhje të të gjitha procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit të pambaruar ose të kërcënuara, ose që mund të përfshijnë NP-në; një përshkrim të procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit të cila NP pritet t'i iniciojë gjatë tremujorit aktual; transaksionet e konsiderueshme që përfshijnë NP ose njësitë e saj ndihmëse; dhe sugjerime dhe propozime për ndryshime të cila me arsye pritet që ta rrisin përformancën e NP-së.

Raporti i NPL Kuzhina Qendrore sh.a. për periudhën raportues në vete përmban informata të thukëta sa i përket ndërmarrjes, historisë së krijimin. Flet për misionin dhe vizionin e saj si dhe paraqet objektivat zhvillimore për periudhën në vijim.

Në një pjesë, raporti flet për angazhimet, detyra dhe përgjegjësit e Bordit të Drejtorëve, dhe pasqyron angazhimin e tyre në drejtim të konsolidimit dhe forcimit të ndërmarrjes.

Raporti nuk le pa përmendur edhe zhvillimet e brendshme në ndërmarrje, veçmas tek respektimi i marrëveshjeve që ka me Komunën e Prishtinës për transferimin e një numri të caktuar të punëtorëve, proces siç do të shihet më poshtë është realizuar nga ana e ndërmarrjes

Raporti përfshinë punën e të gjitha departamenteve të ndërmarrjes dhe aty paraqiten të gjitha veprimet që janë bërë. Jepet një pasqyrë e aktiviteteve që kanë ndodhur në administratën e ndërmarrjes, siç është transferimi sipas marrëveshjes më Komunën për transferimin e një numri të punëtorëve. Pasqyrohet të dhëna rreth kontakteve të përditshme më partnerët tanë, siç janë Institucionet Parashkollorë Publike dhe ato më bazë në komunitet.

Raporti shpërfaqe edhe lëvizjet financiare që janë bërë në ndërmarrje nga 1 Janari deri më 31 Mars 2022. Aty shihet që ndërmarrja ka pasur në vazhdimësi një trend rritës dhe ka pasur tendencë të dërgimit të shujtave sipas porosive edhe tek operatorët e tjerë, pra jo vetëm tek sektori publike.

Kjo periudhe përshkruhet më një aktivitet të shtuar të Zyrës së Prokurimit, e cila ka shpallur dhe përfunduar disa procedura tenderuese, të cilat kanë pasur një ndikim të jashtëzakonshëm në mbarëvajtjen e punëve në ndërmarrje.

Kontakti me institucionet e tjera publike si dhe më ndërmarrjet partnere, qofshin të nivelit lokal apo qendrore, nuk ka munguar, dhe siç paraqitet në raport ka qenë mjaftë i dendur, duke filluar nga Administrata Tatimore e deri të ndërmarrjet publike qendrore dhe lokal.

Sa i përket buxhetit të ndërmarrjes, raporti tregon se ky tremujor ka një trend pozitiv të të hyrave, çka i kanë siguruar ndërmarrjes një stabilitet solid në kryerjen e të gjitha obligimeve të mëhershme apo të krijuara gjatë kësaj periudhe.

Duke shpresuar që kemi arritur t'i përmbledhim të gjitha punët dhe angazhimet që janë bërë nga stafi i Ndërmarrjes Publike Lokal Kuzhina Qendrore sh.a., ju falënderojmë për bashkëpunimin e treguar gjatë gjithë kësaj kohe.

Faleminderit!

Për ndërmarrjen

Ndërmarrja Publike "Kuzhina Qendrore" sh.a. është themeluar me datën 5 Qershor 2019 nga Kuvendi Komunal i Prishtinës.

Struktura organizative e ndërmarrjes është e ndërtuar bazuar në përgjegjësit ligjore që rrjedhin nga Ligji nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike. Ndërmarrja udhëhiqet sipas kësaj hierarkie: Komisioni Komuna i Aksionare, që emërohet nga Kuvendi Komunal dhe Kryetari i Komunës, Bordi i Drejtorëve që emërohen përmes një procesi rekrutues nga Komisioni Komunal i Aksionarëve si dhe Kryeshefi Ekzekutiv i ndërmarrjes që përmes një procesi rekrutues emërohet nga Bordi i Drejtorëve të ndërmarrjes. Kjo është struktura e nivelit të lartë që menaxhon me ndërmarrjen.

Kuzhina Qendrore aktualisht furnizon gjithsej 16 çerdhe, prej të cilave 8 janë publike dhe 8 me bazë në komunitet (Lista në Anex 1). Bazuar në kapacitetet aktuale, ndërmarrja mundet në çdo kohë të rris kapacitetin e shujtave për këtë kategori të shoqërisë nëse diçka e tillë kërkohet.

Aktualisht, ndërmarrja përgatitë 3 shujta në ditë për afërsisht 2490 fëmijë prej të cilëve 1651 të çerdheve publike dhe 839 fëmijë nga çerdhet me bazë në komunitet si dhe 500 shujta ne dite për 2 Qendrat Sociale (Aktash dhe Tophane). Gjatë vitit të parë të projeksioneve, numri i fëmijëve në çerdhe publike do qëndroj i njëjtë përgjatë periudhës 2021-2022.

Ndërmarrja Publike " Kuzhina Qendrore "sh.a, me zhvillimet e saja ndër vite ka arritur që të jetë një ndërmarrje e suksesshme në përgatitjen e ushqimit cilësor e të standardizuar për çerdhet dhe institucionet parashkollore publike në baza ditore. Kuzhina Qendrore ka pajisje të sofistikuara në fushën e gastronomisë, duke dhënë përgjegjësi te lartë ne përgatitjen e shujtave për fëmije dhe shpërndarjen ditore të tyre.

Vizioni i Kompanisë

N.P.L "Kuzhina Qendrore", sh.a. ka vizion të bëhet sinonim i ushqimit te shëndetshëm në Komunën e Prishtinës, dhe të njihet si shembull i përsosmërisë në ofrimin e produkteve ushqimore për fëmijët, bizneset dhe qytetaret e saj, si dhe duke aplikuar praktika më të mira Evropiane.

Misioni i Kompanisë

Misioni ynë është të vazhdojmë angazhimin për ushqim të shëndetshëm, me cilësi, standarde të larta, shije të mirë dhe çmim të volitshëm.

Qëllimet

Kuzhina Qendrore ka për qellim që të jetë një ndërmarrje publike e suksesshme, e qëndrueshme financiarisht, me synim të zgjerimit të investimeve të reja kapitale në kapacitetet prodhuese e

shërbyese në gastronomi, investimet kapitale në industritë ndërlidhëse prodhuese (ushqimore), të arrij kapacitetin maksimal prodhues në fushën e industrisë ushqimore dhe të bëhet faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik lokal.

Objektivat e ndërmarrjes

Ndërmarrja publike lokale "Kuzhina Qendrore" sh.a. brenda funksionimit të saj dhe brenda detyrave primare, që ia përcakton fushë veprimtari që ushtron por edhe aktet ligjore, ka analizuar dhe hartuar disa caqe afariste të cilat i ka shndërruar në objektiva dhe aktivitete:

- Shtimi i kapaciteteve të furnizimit të Institucioneve Parashkollore, pavarësisht natyrës, me ushqim të freskët, cilësor dhe të bollshëm;
- Shtimi i kapaciteteve prodhuese përmes investimeve të reja kapitale;
- Zgjerimi i bashkëpunimit me institucione publike dhe institucione tjera relevante për furnizime me shujta ditore;
- Zgjerimi i bashkëpunimit me bizneset private për furnizim të rregullt me shujta ditore.

Korniza Ligjore

Ndërmarrja Publike Lokal "Kuzhina Qendrore" sh.a., është themeluar bazuar në Ligjin nr. 03/L-87 për ndërmarrjet publike. Është themeluar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, ku Komuna e Prishtinës është aksionar i 100%. Ndërmarrja fushë veprimtarinë e vet e bazon ne Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare, si dhe në aktet e brendshme të nxjerra nga Aksionarët dhe Bordi.

Gjatë tremujorit të parë të këtij viti, ndërmarrja ka arritur që ti plotësoj dhe ndryshoj disa rregullore, që janë të domosdoshme për funksionalitetit e punëve në ndërmarrje. Janë propozuar dhe miratuar këto akte të brendshme:

- Rregullore për Marrëdhënien në Punës;
- Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës
- Organogramin e N.P.L "Kuzhina Qendrore sh.a

Rregulloret e përmendura me larte janë përpiluar në bashkëpunim dhe me ndihmën e drejtorëve të Bordit Drejtues të cilat kanë dhënë mundin e tyre për të përfunduar këto dokumente bazike për funksionimin institucional të ndërmarrjes.

Përveç këtyre ka filluar puna në plotësimin dhe ndryshimin e rregulloreve që kanë një lidhshmëri bazike më Rregulloret e përmendura me lartë. Ndër Rregulloret që ka filluar procesi i plotësim ndryshimit janë:

- Rregulloren për përgjegjësin disiplinore dhe materiale,

- Rregullore mbi Pagat dhe Kompensimet e tjera
- Rregullore për Orarin e Punës
- Udhëzim mbi përshkrimin e detyrave të punës

Ndryshimet në Statutin e ndërmarrjes pritet të fillojnë në momentin e konstituimit të Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Bordi i drejtorëve

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-87 për ndërmarrjet publike, Bordi i drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Kuzhina Qendrore sh. a., është në përbërje prej katër (4) drejtorëve që zgjidhen në një mbledhje të aksionarëve në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe secili ka mandat prej tri (3) viteve, ndërkohë anëtari i 5 i Bordit është Kryeshefi Ekzekutiv, i cili emërohet nga Bordi përmes procesi rekrutues. Sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Drejtorët e Bordit për punën dhe përgjegjësit e tyre i raportojnë Komisioni të Aksionarëve.

Gjatë periudhës raportuese Bordi i Drejtorëve të NPL Kuzhina Qendrore sh.a. ka mbajtur 5 mbledhje, ku janë shqyrtuar dokumente dhe procese me rendësi për ndërmarrjen. Ndër çështjet që janë miratuar nga ana e Bordit të Drejtorëve janë aktet e tjera si në vijim:

- Rregullore për Marrëdhënien në Punës;
- Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës
- Organogramin e N.P.L "Kuzhina Qendrore sh.a
- Deklarata për Politikën e Kompensimit të Drejtorëve të Bordit të Drejtorëve dhe Zyrtarëve të Ndërmarrjes;
- Vendimi për caktimin e shpenzimeve të reprezentacionit dhe shpenzimit për mbushje telefonike në ndërmarrje;
- Marrëveshja e Mirëkuptimit në mes të Kuzhinës dhe QKMF-së

Gjatë aktivitetit të tij, Bordi i Drejtorëve përveç rolit ligjor ka asistuar menaxhmentin e ndërmarrjes edhe në çështje të tjera organizative brenda ndërmarrjes duke u bërë kështu pjesë e pandashme e punës ekipore të ndërmarrjes.

Bordi ka këshilluar dhe rekomanduar menaxhmentit që të inicioj procesin e ristrukturimit të ndërmarrjes duke nisur nga sistematizimi i të punësuarve nëpër vendet e punës, lëvizjen e disa prej tyre në vendet ku nevojat e ndërmarrjes janë me të theksuara etj.

Zyra e Kryeshefit

Periudha raportuese është kategorizuar me ndërrimin e menaxhmentit të ndërmarrjes. Në Janar të këtij viti është bërë dorëzim pranimi i detyrës nga ish u.d. i kryeshefit Sokol Ukaj, tek kryeshefi i zgjedhur Asdren Osaj. Kryeshefi i ri është zgjedhur bazuar në Ligjin nr. 03/L-87 për ndërmarrjet publike, nga Bordi i Drejtorëve, përmes një procesi të hapur konkurrues.

Në kuadër të Zyrës së Kryeshefit, sipas Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, përfshihen Zyra për Marrëdhënie me Publikun, Zyra Ligjore, Zyra e Prokurimit dhe Zyra e Auditimit.

Memorandume bashkëpunimi dhe marrëveshje për shërbime

Ndërmarrja në periudhën raportuese ka qenë e fokusuar në krijimin e kushteve për operimin në tregun jashtë Marrëveshjes në Shtëpi që e ka më Komunën e Prishtinës, e cila siguron dërgimin e shujtave të ngrohta për 16 Institucione Parashkollore dhe 500 shujta për rastet në gjendje të rëndë sociale. Ndërmarrja ka arritur që të nënshkruaj një (1) Memorandum të Bashkëpunimit për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, për dërgimin e shujtave të ngrohta falas për personelin mjekësor dhe teknik për Qendrën e Vaksinimit.

Është negociuar dhe dakorduar nënshkrimi i dy marrëveshjeve për shërbime me operatorët privat për dërgimin e shujtave të ngrohta. Marrëveshja e parë që është dakorduar është për dërgimin e 30 shujtave të ngrohta për operatorin privat Selman's Networkt për një periudhë 6 mujore me një çmim prej 2 euro për shujtë, shërbimi për të cilën sipas dakordimit ka qenë nga muaji Prill.

Risi deri më tash është marrëveshja me personat fizik, familjar për dërgimin e shujtave të ngrohta për familjarët e tyre. Në periudhën raportues janë arritur dy marrëveshje të tilla – njëra për dërgimin e shujtave për familjar për të pame dhe tjetra e cila po ashtu është planifikuar të filloj se zbatuari nga muaji Prill është dërgimi i shujtave në familje. Marrëveshja e parë për dërgimin e shujtave për të pamë është bërë me familjen Berisha (punëtor i ndërmarrjes) më çmimin ekzistues 1.3 euro për shujtë dhe janë dërguar në tërësi 260 shujta, ndërsa e marrëveshja e dyte është me Familjen Sadiku, më çmim 2 euro për shujtë, po ashtu për një periudhë 6 mujore.

Synimi ynë është që të rrisim prezencën tonë në tregun privat, duke u siguruar për shërbime dhe ushqim cilësor.

Takime pune

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive gjatë periudhës raportuese janë organizuar një serë takimesh me palët e interesit por edhe me stafin e ndërmarrjes. Takimet me stafin e ndërmarrjes kanë qenë të rregullta javore.

Është zhvilluar takim me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, ku është synuar të behet riorganizimi dhe përmirësimi i kushteve të shpërndarjes se shujtave për rastet me gjendje të rend sociale.

Si rezultat është arritur dakordimit që menjëherë pasi t'i përfundon procedurat tenderuese Komuna e Prishtinës, të fillohet me shpërndarjen e ushqimit të paketuar si dhe të rritet numri i shujtave nga 500 sa është tash në 700 në të ardhmen.

Propozimi ynë në këto takime ka qenë që shpërndarja e shujtave të decentralizohet edhe në 3 ose 4 pika të tjera, veçmas në zonat me të thella rurale të Prishtinës, për t'iu mundësuar qytetarëve në nevojë, furnizim me të lehtë më shujta. Komuna e ka përkrahur këtë ide dhe ka mbetur që ajo të organizohet rreth mënyrës se realizimit të saj.

Po ashtu është zhvilluar takim me Departamentin e Shëndetësisë, ku është dakorduar shpërndarja e shujtave për mjeket si dhe është përgatit plani, që në rast nevoje të rritet numri i shujtave dhe shpërndarja e tyre të bëhet edhe në pikat tjera.

Takimi me Departamentin e Financave në Komunën e Prishtinës, ka pasur si qellim të qartësoj shqetësimet rreth vonesave në ekzekutimin e pagesave të faturave të ndërmarrjes. Në takim është arritur marrëveshja që faturat të paguhen sipas Marrëveshjes në Shtëpi të nënshkruar nga kryetari i Komunës dhe Kuzhina Qendrore.

Ndërkohë Kryesuesi i Bordit, bashkë me drejtorin të QKMF-së z. Bujar Gashi, kanë vizituar Qendrën e Vaksinimit në lagjen Kalabria me që rast nga afër kanë parë shërbimin tonë tek kjo qendër, duke marrë kështu vlerësime pozitive nga stafi i kësaj qendre.

Është organizuar një takim me drejtoreshat e Institucioneve Parashkollore, mbledhje e mbajtur kjo me dt. 31.01.2022, ku në përjashtim të mungesës së përfaqësimit të IP "Ngjyrat" dhe IP "Lulevera" të gjitha drejtoreshat e IP-vë tjera kanë qenë prezent. Për këtë takim kemi mbajtur procesverbalin dhe në të është e shkruar përmbajtja e takimit.

Është realizuar një takim në Oden Ekonomike Gjermane me seli në Kosovë, ku kemi gjetur mbështetje për ofrimin e shërbimit nga kjo Odë, me dy ekspertë gjerman të cilët do të kryenin ekspertizën për riorganizimin e administratës dhe po ashtu për ri përpilimin e menysë ushqimore, me që rast menyja e ndërmarrjes tonë do të pasurohet dukshëm.

Është punuar shumë në krijimin dhe plotësimin e akteve nën ligjore të ndërmarrjes dhe në këtë drejtim në periudhën raportuese janë aprovuar këto:

- Rregullore për Marrëdhënien në Punës;
- Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës

- Deklarata për Politikën e Kompensimit të Drejtorëve të Bordit të Drejtorëve dhe Zyrtarëve të Ndërmarrjes;
- Vendimi për caktimin e shpenzimeve të reprezentacionit dhe shpenzimit për mbushje telefonike në ndërmarrje;
- Marrëveshja e Mirëkuptimit në mes të Kuzhinës dhe QKMF-së
- Vendimi për rendin shtëpiak në Kuzhinë;
- Vendimi për sigurinë gjatë shpërndarjes se ushqimit;
- Vendimi për Transferim të një serviruese nga IP Ardhmëria tek IP Buzëqeshja;
- Vendimi për Transferim të një serviruese nga IP Ardhmëria tek IP Gëzimi Ynë;
- Vendimi për Transferim të një serviruese nga IP Dielli tek IP Yllkat;
- Vendimi për Transferimin e dy punonjësve teknik në vendin e punës shofer/asistent shoferi;
- Kërkesë për anulimin e Konkursit Publik të shpallur me 5.11.2021;
- Vendimi për themelimin e Komisionit adhoc disiplinor;
- Vendimin për themelimin e Komisionit adhoc të ankesave për shqyrtimin e vendimit të Komisionit Disiplinor;
- Vendimi për shkurtimin e orarit të punës të një punonjëse, sipas rekomandimit të QKMP (Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës)
- Vendimi për inventarizim dhe regjistrim të pasurisë së ndërmarrjes.

Informimi dhe avokimi

Që nga themelimi ndërmarrja është karakterizuar më mungesë të prezencës në mjetet e informimit dhe në opinionin publik në përgjithësi.

Në periudhën raportuese është arritur që të funksionalizohet faqja e ndërmarrjes në rrjetin social Facebook dhe njëkohësisht edhe të pasurohet më informata.

Është dizajnuar, punuar dhe funksionalizuar ueb faqja e ndërmarrjes, që është një dritare e mirë e komunikimit me opinionin. Ueb faqja është pasuruar me dokumentet e nevojshme ekzistuese të ndërmarrjes si dhe ofron një qasje të lehtë për të interesuarit deri tek informata e kërkuar.

Tendenca e jonë është që të forcojmë këtë sektor dhe njëkohësisht ta lehtësojmë qasjen deri tek informata.

Zyra e Prokurimit

Ish Departamenti i Prokurimit, tash i paraparë më Rregulloren e re për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës si Zyre e Prokurimit, ndonëse e pa kompletuar me staf, për shkak të kufizimeve financiare, ka ushtruar aktivitete të ngjeshur gjatë periudhës raportuese.

Ndërmarrja ka iniciuar procedura prokurimi për përmbushjen e nevojave afariste. Me bartjen e administratës në objektin e kuzhinës ka qenë e nevojshme investimi në hapësirat punuese si: Montim dhe furnizim me dyer dhe dritare; Instalim i kamerave dhe sistemit për hyrje dalje. Të gjitha këto projekte tashme janë realizuar dhe janë në proces të pagesës së faturave, varësisht kohës kur operatori dorëzon faturën.

Proceset e tjera të prokurimit të cilat janë në pritje të realizimit janë: Furnizimi me pajisje teknologjikë; Blerja e programit të kontabilitetit, Dizajnimi, krijimi dhe mirëmbajtja e ueb faqes së ndërmarrjes. Ndërkohë që gjatë kësaj periudhe raportues është bërë edhe shpallja e tenderit për Furnizim me materiale higjienikë dhe për Furnizim me pemë e perime.

Tab. 1. Aktivitetet e Zyrës së Prokurimit

Procedurat e prokurimit	Shuma (€)	Statusi
Furnizim dhe instalim i kamerave	968.65	E përfunduar
Furnizim dhe instalim i sistemit të menaxhimit të hyrje-daljeve	350.00	E përfunduar
Furnizim dhe montim i dyerve	3,558.60	E përfunduar
Furnizim me pajisje të teknologjisë informative (PC)	1,660.00	E përfunduar
Furnizim me program të kontabilitetit	944.00	E përfunduar
Krijim, dizajnimi dhe mirëmbajtje e ueb faqes	977.00	E përfunduar
Furnizim me materiale higjienikë	30,000.00	Në proces
Furnizim me pemë dhe perime	70,000.00	Në proces

Departamenti i Administratës

Në periudhën raportuese në Departamentin e Administratës pjesërisht janë funksionalizuar Sektori i Zhvillimit të Projekteve dhe Sektori i Logjistikës. Funksionet tjera të sektorëve të tjerë do funksionalizohen në bazë të planifikimeve të brendshme të institucionit tonë.

Aktivitetet e Departamentit të Administratës në periudhën raportuese kryesisht kanë qenë të fokusuara në krijimin e kushteve të punës në ndërmarrje.

Në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit në mes të Komunës së Prishtinës dhe N.P.L "Kuzhina Qendrore" sh.a. me nr. protokolli 14-024/01-246399/21/2, dt. 04.11.2021 në Janar të këtij viti është finalizuar transferimi i 36 punëtorëve nga Komuna e Prishtinës tek N.P.L "Kuzhina Qendrore" sh.a.

Me këtë rast i gjithë ky staf ka lidhur marrëdhënie pune me ndërmarrjen, rrjedhimisht nga muaji Janar janë staf i rregullt i ndërmarrjes.

Vlen të theksohet që një pjesë e këtij stafi/servirueset janë të deleguara tek Institucionet Parashkollore ku kryejnë funksionin e shërbimit të ushqimit.

Me kërkesë të menaxhmentit të lartë të ndërmarrjes është anuluar konkursi publik i shpallur në muajin Nëntor 2021 nga Komuna e Prishtinës, për nevoja të ndërmarrjes pasi janë gjetur shkelje të procedurave të konkurseve

Në muajin shkurt administrata e ndërmarrjes përveç tjerash ka zhvilluar disa procese pune edhe përmes funksionit të zhvillimit dhe menaxhimit të projekteve, ka kontaktuar organizatën gjermane Gizz (Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbiten), ku janë diskutuar mundësit e bashkëpunimit në fushën e granteve dhe projekteve të tjera që përkrahën nga GIZZ.

Janë përpiluar edhe kontratat e dy punonjësve të reja të cilat janë angazhuar në plotësimin e stafit të serviruesve pas kërkesave të IP-ve bërë ndaj ndërmarrjes tonë.

Ato janë angazhuar me kontrata për punë specifike në bazë të normave të brendshme dhe në bazë të dispozitave ligjore të ligjit të punës 03/L-212.

Është riparuar dhe lëshuar në funksion gjeneratori i ndërmarrjes. Departamenti në bashkëpunim me Komunën ka arritur të siguroj furnizimin e rregullt me naftë për gjenerator dhe rrjedhimisht ka siguruar një rezervar me kapacitet prej 3 mijë litrave. Aktualisht rezerva të naftës për gjenerator ndërmarrja i ka 1 mijë litra.

Është ndërhyrë në infrastrukturën e brendshme të ndërmarrjes. Është bërë gëlqerosja e ambienteve të brendshme të Kuzhinës; është bërë ndriçimi i jashtëm i objektit.

Në periudhën raportuese është bërë instalimi i kamerave të sigurisë brenda dhe jashtë objektit të ndërmarrjes, ndërkohë është instaluar sistemi automatik i hyrje daljeve në objekt, që bënë evidentimin e prezencës se punëtorëve në punë.

Përveç kësaj është bëre instalimi i pajisjeve që kufizojnë qasjen në ambientet ku përgatitet ushqimi dhe të drejtë qasje në këto ambiente kanë vetëm kuzhinierët, të cilët janë të pajisur me kartela për lejim të qasjes.

Departamenti i Prodhimit

Sipas Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës ish Operative është shndërruar në Departament të Prodhimit, që përfshin në vete pjesën e përgatitjes së ushqimit. Departamenti në vete ka 10 kuzhinier në angazhim.

Gjatë periudhës raportues, Departamenti ka arritur të përgatisë 140 mijë shujta për Institucionet Parashkollore dhe Qendrat Sociale, si dhe 2128 shujta për Qendrën e Vaksinimit.

Gjatë periudhës raportuese departamenti ka qenë i fokusuar në rritjen e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit.

Pjesë e veçantë e angazhimit të këtij departamenti ka qenë përgatitja e shujtave shtesë për personelin mjekësor dhe teknik për Qendrën e Vaksinimit në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare.

Përveç punëve dhe detyrave të përcaktuara, Departamenti ka kryer edhe punët e Departamentit të Furnizimit dhe Distribuimit, meqë ky departament është në themelim e sipër.

Është bërë përgatitja e rregullt mujore e specifikacioneve të shujtave të cilat dërgohen në baza të përditshme në institucionet e IP, si dhe përgatitjen e konstatimeve të furnizimit nga operatorët ekonomik. Është bërë përgatitja mujore e specifikacionit dhe konstatimit për përgatitjen e faturës që i dërgohet Komunës, sipas Kontratës në shtëpi, të nënshkruar më Komunën e Prishtinës.

Është kujdesur dhe ka mbajtur kontakte të rregullta me Departamentin e Arsimit për ekzekutimin e pagesës se faturave si dhe në të njëjtën kohë ka mbajte kontakt më të gjitha Institucionet Parashkollore për tu kujdesur për mbarëvajtjen e procesit të përgatitjes dhe shpërndarjes se ushqimit.

Tab. 2 Përgatitja e shujtave Janar – Mars 2022

Numri i shujtave		
Muaji	IP dhe Qendrat Sociale	Qendra e Vaksinimit
Janar	41912	838
Shkurt	57224	1290
Mars	40955	
Total	140091	2128

Departamenti i Financave

Departamenti i financave për periudhën raportuese ka menaxhuar me gjithë procesin e financave, duke përfshirë edhe përgatitjen e listës së pagave dhe ekzekutimin e saj. Krahas punëve të tjera Departamenti i Financave ka qenë i angazhuar edhe në punë që janë në fushë veprimtari të departamenteve ose zyrave të tjera, siç është Zyra për Burimet Njerëzore dhe Departamenti për Furnizim dhe Distribuim.

Departamenti ka arritur që me sukses t'i përfundoj të gjitha procedurat, me përkrahjen e Zyrës së Prokurimit për instalimin e Sistemit të Kontabilitetit

Për përudhen raportuese N.P.L Kuzhina Qendrore, sh.a. ka arritur të i kryej të gjitha obligimet ndaj punëtorëve siç janë pagat dhe transferet e tjera të parapara me normat ligjore.

Gjatë kësaj periudhe buxheti për paga është siguruar nga të hyrat që ndërmarrja siguron nga shitja e shujtave. Totali i buxhetit të pagave të shpenzuar për këtë periudhë raportuese është 75433.53€. Buxheti ka lëvizur nga muaji në muaj për shkak të lëvizjes se numrit të punëtorëve dhe pagesave të vonuara për Komisionin Komunal të Aksionarëve dhe të vonesës se honorarit për kryesuesin e Bordit të Drejtorëve, ndalesë kjo që ishte bërë më kërkesë të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Tab. 3 Shpenzimet për paga dhe kompensime të tjera

	Janar 2022	Shkurt 2022	Mars 2022
Pagat bruto	22323.53	24989.8	28120.2
Pagat neto	20289.3	22477.48	25323.27
Tatimi në paga	1018.98	1181.98	1385.56
Kontributet e punëtorit	1116.17	1249.29	2811.22
Kontributet e punëdhënësit	1116.17	1249.29	2811.22

Tabela në vijim tregon shpenzimet e bëra për periudhën raportues, për Drejtorët e Bordit të Drejtorëve, të cilat kategorizohen në honorarë. Shpenzimet kanë pasur trend rritës për shkak të përfshirjes së më vonshme të Komisionit Komunal të Aksionarëve në listën e pagave.

Tab. 4 Pagesa për anëtarët Bordit të Drejtorëve dhe Komisionin Komunal të Aksionarëve

Bordi dhe Aksionaret	Janar	Shkurt	Mars	Total
Honorari	1,160.00	2,420.00	2,464.00	6,044.00

Tab. 5 Shpenzimet për mbushje telefonike dhe Shpenzimet e mbledhjeve.

Shpenzime për tel	140	140	140	420
Shpenzime për mbledhje	7.2	78.8	0	86

Shpenzimet e reprezentacionit janë të rregulluara me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të aprovuar në mbledhjen e dytë të bordit. Sipas këtij vendimi të drejtë në reprezentacion kanë pozitat e larta drejtuese të ndërmarrjes.

Kryeshefi Ekzekutiv gëzon një shumë të aprovuar për reprezentacion prej 200 euro në muaj. Shpenzimet e Kryeshefit Ekzekutiv të përmbledhura për tre muaj janë 177.34 euro, të cilat janë të mbështetura në fatura të rregullta. Totali i shpenzimeve për reprezentacion për tre muaj është 194.64 euro.

Tab. 6 Shpenzimet e reprezentacionit

Reprezentacion në €	Limiti i aprovuar	Të shpenzuara			
		Janar	Shkurt	Mars	Totali
Kryeshefi ekzekutiv	200	0	92.51	84.83	177.34
Departamenti i Administratës	50	0	0	17.3	17.3

Obligimet Tatimore

Obligimet tatimore ndaj shtetit, janë paguar në tërësi. Për muajt paraprak (Dhjetor dhe Nëntor) për shkak të vonesës së pagesës, ndërmarrja është ndëshkuar duke paguar vlerë shtese (ndëshkime dhe interes) për mos pagesën e TVSH-së dhe Raportit tre mujor në kohë. Për muajin Mars nuk është deklaruar ende TVSH mirëpo përllogaritet të jetë rreth 7000 euro. Kurse pagesa e Tatimit në Fitim për tre mujorin e parë të vitit 2022 përllogaritët të jetë 1542.8 euro.

Tab. 7 Llogaritja e tatimit në fitim

Të ardhurat e parapara për Periudhën Tatimore/4	36545.51
Shpenzimet e parapara për Periudhën Tatimore/4	21117.42
Fitimi i paraparë për Periudhën Tatimore /4	15428.09
Kësti për TM1 (10%)	1542.80

Tab. 8 Pagesa e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

TVSH	Janar	Shkurt	Mars	TOTALI
	8,278.86	10,376.85	6783.14	25,438.85

Tab. 9 Ndëshkimet në vonesa

TVSH	Borxhi	Ndëshkime	Interesi	TOTALI
DHJETOR/NENTOR	2,520.13	50.40	32.76	2,603.29
QS (Këstet tre mujore për korporatat e vogla)	2835.14	56.7	36.86	2,928.7

Shpenzimet e tjera

Krahas shpenzimeve fikse të furnizimit, ndërmarrja në periudhën e raportuar ka krijuar edhe shërbime të tjera për mallra dhe shërbime. Duke qenë ndërmarrje e re në konsolidim e sipër, ndërmarrja ka krijuar shpenzime për mallra dhe shërbime.

Tab. 10 Mallra dhe shërbime

		TM1
Shpenzimet për naftë		230.52
Shpenzime për zyre		632.39
Shpenzime për komunali		65.2
Ushqim dhe pije		378
Pajisje për Kuzhinë		45
Shpenzime për dezinfektim		150
	Total	1501.11 €

Ngritja e kapaciteteve të ndërmarrjes

Ndërmarrja është në proces të ristrukturimit nga një entitet që ka punuar në kuadër të Komunës së Prishtinës, në një entitet të pavarur bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare, si ndërmarrje publike.

Ndërmarrja ka trashëguar një staf, ku shumica prej tyre kanë përgatitje të mesme shkollore. Përveç kësaj stafi është në moshë të shtyrë. Ndërmarrja po ashtu ka trashëguar një listë të punëtorëve që kanë qenë të angazhuar nga Komuna e Prishtinës për një periudhe mbi tre vjeçare më kontratë për punë dhe detyra specifike.

Në bashkëpunim me Oden Ekonomike Gjermani kemi punuar për angazhimin për një periudhë të caktuar kohore të ekspertëve të kulinarisë, që do të mund të zhvillonin trajnime në vendin e punës për stafin e Kuzhinës Qendrore.

Në tremujorin e parë është bërë vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të ndërmarrjes për investime në ngritjen e kapaciteteve, jo vetëm në personel por edhe në makineri.

Kemi angazhuar ekspert për të vlerësuar kapacitetin prodhues dhe jetëgjatësinë e pajisjeve të instaluara në Kuzhinë. Gjatë muajit Mars është bërë vlerësimi, ndërkohë në Prill presim raportin që është një përshkrim se si të veprohet në muajt në vijim.

Fund!

Anex 1 Lista e Institucioneve parashkollore

I. Publike

1. IP Yllkat
2. IP Ardhmëria
3. IP Xixëllonjat
4. IP Dielli
5. IP Buzëqeshja
6. IP Fatosat
7. IP Lulevera
8. Gëzimi Ynë

II. Me bazë në komunitet

1. IP Botanika
2. IP Cicërimat
3. IP Këtrushet
4. IP Milingonat
5. IP Ngjyrat
6. IP Shkronjat
7. IP Zogjet
8. IP Shtëpia magjike